



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 20/12/2018

**V E N D I M**

**Nr.218, Datë 20/12/2018**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT "MBI REFLEKTIMIN NË KONTABILITET DHE PASQYRA FINANCIARE TË AKTIVITETIT TË PROGRAMEVE BUXHETORE TË CILAT NË ZBATIM TË VKM-VE PËRKATËSE KALUAN NË PËRGJEGJËSINË SHTETËRORE, TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT"**

**për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.**

Nga auditimi Tematik ÷Mbi reflektimin në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, konstatohet se, FSHZH me Aktin Normativ nr.3 datë 06.11.2017 ka marrë nën administrim vetëm një program buxhetor nga ish Ministria e Zhvillimit Urban, pra programin ÷Infrastruktura Vendore dhe Rajonaleö prej 7,400,000 mijë lekësh. Pjesa më e madhe e këtij programi rreth 90% ekzekutohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe pjesa tjetër nga institucionet e qeverisjes qendrore.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik ÷Mbi reflektimin në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programit buxhetor i cili në zbatim të Aktit Normativ nr.3 datë 06.11.2017 kaloi në përgjegjësinë shtetërore të Fondit Shqiptar të Zhvillimitö dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të Ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 ÷Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitö,

**VENDOSA**

**I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit ÷Auditim Tematikö të ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit sipas programit të auditimit nr.1045/2, datë 17.09.2018, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.**

**II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:**

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit me Aktin Normativ nr.3 datë 06.11.2017 ka marrë nën administrim vetëm një program buxhetor nga ish Ministria e Zhvillimit Urban, pra programin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" prej 7,400,000 mijë lekësh.

Pjesa më e madhe e këtij programi rreth 90% ekzekutohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe pjesa tjetër nga institucionet e qeverisjes qendrore.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit në cilësinë e Sekretariatit Teknik për programin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" është përgjegjës për monitorimin e ecurisë së projekteve, si dhe rishpërndarjen e fondeve midis tyre.

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë auditimit të projekteve të programit "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" ndër vite në njësitë shpenzuese respektive ka konstatuar problematika të shumta në lidhje me procedurat e prokurimit të fondeve, ekzekutimin e pagesave, krijimin e detyrimeve të prapambetura, ecurinë e projekteve, mbylljen e projekteve të papërfunduara dhe hapjen e projekteve të reja si dhe mosreflektimin e rishpërndarjes së fondeve gjatë vitit në treguesit fiskal.

**1.1 Rekomandimi:** Kontrolli i Lartë i Shtetit i rekomandon strukturave drejtuese të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës të këtij programi, monitorimin me prioritet të këtij programi buxhetor me qëllim evidentimin e parregullsive dhe parandalimin e problematikave të mësipërme.

*Në vijimësi*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**